

URDHËR
Nr. 1047, datë 2.12.2024

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQATËS “AGJENCIA E
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORËVE (ALBAUTOR)” SI
AGJENCI E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË
AUTORIT PËR VEPRAT LETRARE, ARTISTIKE DHE SHKENCORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, vendimit nr. 33, datë 1.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit”, si dhe udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës”,

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës për subjektin ALBAUTOR, shoqatë e regjistruar me vendimin nr. 578, datë 18.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT: J81512003D, si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit në çdo krijim intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, përveçse administrimin kolektiv të të drejtave të autorit të krijimeve audiovizuale, në të cilat përfshihen edhe krijimet kinematografike.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja